



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. ____ prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2025

URDHËR

Nr. ____, datë ____ . ____ . 2025

PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË MENAXHIMIT TË RISKUT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NGA
INSTITUCIONI I PREFEKTIT TË QARKUT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015, të neneve 15-20, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Urdhër nr 83 dt 12.06.2025 të Ministrit të Brendshëm

URDHËROJ:

1. Miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.
2. Ngarkohet grupi i menaxhimit të riskut për monitorimin dhe koordinimin e kësaj strategjie.
3. Ngarkohen të gjithë sektorët për zbatimin e këtij urdhri.
4. Publikimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve, në faqen zyrtare të institucionit të Prefektit të Qarkut.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

Konceptoi: S.Zeqja

L. Zeka


E. Çato

R. Metanaj

V.Rustani

Miratoi: E.Jonuzi

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NGA INSTITUCIONI I
PREFEKTIT TË QARKUT DURRËS



Durrës, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve	4
----------------------------------	----------

Baza ligjore.....	5
I. Hyrje.....	6
II. Misioni.....	7
III. Objektivat kryesorë.....	7
III/1 Kuptimi i riskut dhe menaxhimi i tij.....	8
III/2 Vlerësimi i riskut.....	8
III/3 Adresimi i riskut.....	9
IV. Deklarata e Politikës së Menaxhimit të Riskut.....	9
IV/1. Qëllimi i Politikës së Menaxhimit të Riskut.....	10
IV/2. Përmbushja e Qëllimeve.....	10
IV/3. Ecuria e Procesit të Menaxhimit të Riskut.....	11
IV/4. Detyrimet për Realizimin e Politikës.....	11
IV/5. Procedura Kuadër për Menaxhimin e Riskut.....	11
V. Metodologjia.....	12
V/1. Hartimi i Planit Vjetor Punës.....	12
V/2. Hartimi dhe përmirësimi i Rregullores së Brendshme.....	12
V/3. Hartimi dhe përditësimi i Regjistrit të Riskut.....	12
V/3.1. Përkufizimi dhe përshkrimi i riskut.....	12
V/3.2. Faktorët që favorizojnë lindjen e një risku.....	13
V/3.3. Analiza e ndikimit të riskut.....	13
V/3.4. Përcaktimi i mundësisë që risku të ndodhë.....	13
V/3.5. Reagimi ndaj riskut.....	14
V/3.6. Caktimi i detyrave konkrete ndaj një lloji të caktuar risku për punonjësit.....	14
VI. Analiza e Riskut-Grafikë	15
VII. Tabela e Risqeve Kryesore.....	16
VIII. Krijimi i Matricës së Riskut.....	17
IX. Vlerësimi i Riskut Grafikë.....	18
X. Monitorimi dhe Raportimi.....	19

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
MF	Ministria e Financave
MB	Ministria e Brendshme
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
AB	Auditi i Brendshëm
DPKMT	Drejtoria e Politikave dhe Koordinimit për Menaxhimin e Territorit
GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunësi Autorizues
NZ	Nëpunësi Zbatues
PQ	Prefekti i Qarkut
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore

Baza ligjore

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut mbështetet në disa baza ligjore të rëndësishme, që sigurojnë një qasje të strukturuar dhe efektive ndaj menaxhimit të riskut. Kjo strategji është në përputhje me:

1. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015;
2. Ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar;
3. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
4. Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
5. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026;
6. Strategjitë Sektoriale/Ndërsektoriale të Ministrive të Linjës.

Këto baza ligjore sigurojnë që strategjia të jetë e integruar në kuadrin e normativave të përgjithshme dhe të sigurojë një menaxhim të efektshëm dhe të përgjegjshëm të riskut, duke përmirësuar kapacitetin e Institucionit të Prefektit të Qarkut, për të përballuar sfidat dhe situatat e ndryshme që mund të lindin.

I- HYRJE

Risku dhe Menaxhimi i tij janë përkufizuar në nenin 21 të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, i cili specifikon si vijon:

- a. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së mundësisë së ngjarjes.
- b. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në paragrafin më sipër, titullari i Njësisë miraton një strategji e cila përditësohet çdo tre vjet ose, sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Koordinator i Riskut analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit.
- c. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

Në Kreun III të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar përcaktohet marrëdhënia e Prefektit të Qarkut me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, nenet 15-19 dhe në Kreun IV të po këtij ligji, përcaktohet vendimmarrja dhe administrata dhe burimet e financimit të Prefektit të Qarkut, neni 20 dhe 21.

Në Kreun IV të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, përcaktohen marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, neni 13, pika 2.

Në Kreun I të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, përcaktohen marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, neni 2, pikat 9 dhe 10.

Në Objektivin 6 “Rritja e integritetit në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët apo shërbime të tjera” të Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026, parashikohen risqe të lidhura me integritetin, të identifikuara në strukturat dhe institucionet e varësisë të Ministrisë së Brendshme.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në ushtrimin e funksioneve për Prefekturën e Qarkut Durrës.

Prefekti i Qarkut Durrës është fokusuar në menaxhimin e riskut si një element kyç për realizimin e objektivave. Menaxhimi i mirë i tij ndihmon në:

- Arritjen e rezultateve të dëshiruara;
- Marrjen e vendimeve të duhura, duke shfrytëzuar mundësitë.

Risku është përcaktuar si pasiguri e rezultatit, qoftë mundësi pozitive apo kërcënim negativ i veprimeve dhe ngjarjeve.

Risku duhet të vlerësohet në një lidhje të kombinuar midis mundësisë që diçka të ndodhë dhe ndikimit që do të ketë, në qoftë se ajo do të ndodhë me të vërtetë. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe më pas reagimin ndaj tyre.

Menaxhimi i riskut në nivelet strategjike, programore dhe operacionale, ka nevojë për integritet, në mënyrë që nivelet e aktivitetit të mbështesin njëri-tjetrin.

Drejtuesit e çdo niveli, duhet të menaxhojnë riskun në mënyrë efektive, për Njësinë si një e tërë. Për këtë qëllim nevojitet të përgatitet, apo përditësohet regjistri i riskut, në mënyrë që të sigurohet se menaxhimi i riskut është duke u zbatuar në një mënyrë të përshtatshme në çdo nivel.

Zbatimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve (në vijim Strategjia), duhet të futet në të gjitha sistemet e punës së Prefektit të Qarkut Durrës duke përfshirë dhe proceset e vendosjes së politikave, për të siguruar që menaxhimi i riskut është një pjesë e brendshme e mënyrës si njësia funksionon.

II- MISIONI I NJËSISË

Misioni i Prefektit të Qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

III- OBJEKTIVAT KRYESORË TË NJËSISË:

1. Marja e masave për sigurimin e kushteve për zbatimin e ligjit dhe politikave qeveritare.
2. Mbikqyrja e veprimtarisë ligjore të organeve të qeverisjes vendore.
3. Koordinimi i punës së NJ.Q.V me organet e administratës shtetërore në nivel lokal dhe qendror.
4. Njësia ushtron kompetencat e mëposhtme sipas përcaktimeve të nenit 8, të Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar.
 - a) verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;
 - b) bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet degëve territoriale, që veprojnë në qark si dhe të këtyre degëve me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - c) raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e degëve territoriale që veprojnë në qark, sipas urdhrit të Kryeministrit, dhe, për probleme të veçanta, sipas urdhrit të ministrit;
 - ç) informimin çdo gjashtë muaj të institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku;
 - d) nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve e të veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse;
 - dh) drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile;
 - e) drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara;
 - ë) drejtimin ose pjesëmarrjen në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - f) forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit;
 - g) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë;
 - gj) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;
 - h) shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;
 - i) bashkërendimin e punës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor;
 - j) ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore
5. Zhvillimi i burimeve njerëzore për të rritur kapacitetet profesionale të stafit, nëpërmjet:
 - a. Pjesëmarrjes në trajnimet që mbështeten nga donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, si brenda ashtu edhe jashtë vendit;
 - b. Shkëmbimit të njohurive të marra gjatë trajnimeve, ëorkshopeve etj., nga personi pjesëmarrës tek kolegët e institucionit dhe më gjerë;
 - c. Prezantimit të teknikave të reja menaxhuese dhe dokumentare të burimeve njerëzore.
 - ç. Rritjes së motivimit të punonjësve me qëllim përdorimin efikas të njohurive dhe eksperiencës që kanë fituar;

III/1 KUPTIMI I RISKUT DHE MENAXHIMI I TIJ

Në kuptim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, "Risk" është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësisë.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektivat do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së ndodhjes së ngjarjes.

Menaxhimi i riskut nuk është një proces linear, por ai është balancimi i një numri elementësh të ndërthurur, që ndërveprojnë me njëri-tjetrin, të cilët duhet të jenë në ekuilibër, me qëllim që menaxhimi i riskut të jetë efektiv.

Për më tepër, risqet specifike nuk mund të trajtohen në mënyrë të izoluar nga njëri-tjetri, pasi menaxhimi i një prej risqeve mund të ketë ndikim te një tjetër, apo veprimet e menaxhimit të tij mund të jenë të efektshme në kontrollin e më shumë se një risku në të njëjtën kohë.

Modeli i paraqitur tregon thelbin e procesit të menaxhimit të riskut në institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës.

III/2 VLERËSIMI I RISKUT

Vlerësimi i riskut mbështetet në tre parime kryesore:

- Të sigurohemi që ka një proces të strukturuar qartë, në të cilin si mundësia e ndodhjes, ashtu edhe ndikimi, janë marrë në konsideratë për riskun;
- Regjistrimi dhe vlerësimi i saktë i riskut, lehtësojnë monitorimin/identifikimin e prioritetëve ndaj tij;
- Dallimi midis riskut të natyrshëm dhe riskut të mbetur.


Vlerësimi i riskut duhet të bëhet në kohë, i dokumentuar në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, duke marrë në konsideratë aktorët që preken prej tij, për të shmangur vlerësimin konfuz, si dhe për të qenë objektiv në gjykim.


Ky vlerësim duhet të bëhet duke konsideruar, si mundësinë e ndodhjes së riskut, ashtu edhe të ndikimit, nëse ai është realizuar. Ndarja në kategori të lartë /të mesme / të ulët në lidhje me secilin risk, mund të jetë e mjaftueshme, por duhet të ruhet niveli minimal i kategorizimit, e paraqitur në një matricë risku të formës "3x3".

Nuk ka asnjë standard absolut për shkallën e matricës së riskut, por aktualisht Prefekti i Qarkut Durrës, ka arritur një gjykim për nivelin e analizës, bazuar në dokumentet strategjike që disponon, si dhe në ato më të praktikueshmet për rrethana të ndryshme.

Për identifikimin e risqeve janë përdorur si tregues ngjyrat ("dritat e trafikut").

Matrica e riskut





III/3 ADRESIMI I RISKUT

Risqet e identifikuar mund të zvogëlohen ose kufizohen nëpërmjet futjes së aktiviteteve të duhura të kontrollit. Këto mund të jenë:

Kontrollet parandaluese, të konceptuara për të reduktuar mundësinë e ndodhjes së riskut (të tilla si ndarja e detyrave, kufij të qartë të delegimeve të autorizuar);

Kontrolle korrigjuese, të konceptuara për të korrigjuar rezultatet e padëshiruara (të tilla si rikuperimi i pagesave të pasakta);

Kontrolle Udhëzuese, të konceptuara për të garantuar që një rezultat i veçantë është arritur (të tilla si masat e sigurisë apo kërkesat për ruajtjen e shëndetit dhe jetës në punë);

Kontrolle Zbuluese, të konceptuara për të identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (të tilla si kontrolle, monitorimi i aktiveve, apo procedurat e rakordimit).

IV- DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT:

Në kuadër të konsolidimit të institucioneve publike, thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe zbatimit me korrektësi të detyrave dhe funksioneve sipas ligjeve në fuqi, edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës nevojitet përzgjedhje dhe trajnim të punonjësve të administratës e kombinuar me një numër të konsiderueshëm masash të tjera.

Nga ana tjetër, mbetet shumë për të bërë për të shmangur çdo mundësi për abuzim dhe për të rritur besimin e qytetarëve tek institucioni. Rëndësia e këtij dokumenti është së pari, përpjekja jonë e vazhdueshme për të konsideruar integritetin, etikën dhe transparencën, si vlera themelore që i shërbejnë mirëfunksionimit institucional të Prefektit të Qarkut Durrës tek efektet dhe ndikimi i drejtpërdrejtë që kanë masat në forcimin institucional, në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, do të shërbejë si instrument i rëndësishëm për identifikimin dhe parandalimin e risqeve gjatë ushtrimit të funksioneve, ndaj korrupsionit dhe

cënimit të integritetit në fushat e përgjegjësisë më të ekspozuara. Si dokument strategjik, ai reflekton qasjen se si mund të kuptohet, zhvillohet dhe jetësohet menaxhimi i riskut, si dhe ndërtimi i integritetit në institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës. Ai përcakton mënyra dhe mekanizma efektive, të cilat rrisin bashkëpunimin ndërinstitutional me qëllim garantimin e shërbimeve cilësore, të paanshme dhe transparente ndaj komunitetit, si dhe promovimin e vazhdueshëm të një kulture pune në administratën publike.

Zbatimi i plotë i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës do të jetë një hap më pranë përmbushjes së atyre standardeve që dëshirojmë të gjithë.

I pranoj parimet e mëposhtme të Politikës së Menaxhimit të Riskut për Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës dhe do t'i përdor këto ato si orientime për politikën e brendshme të menaxhimit të riskut në institucion.

**PREFEKTI I QARKUT DURRËS
EMILJAN JANI**

IV/1 QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT:

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm, duke kufizuar kostot shoqërore dhe financiare (postulati i kursimit) në minimumin e domosdoshëm.

Gjithashtu ky dokument, pjesë e së cilës është edhe regjistri i riskut, synon të evidentojë dhe të minimizojë risqet të cilat mund të kërcënojnë objektivat e institucionit të Prefektit të Qarkut. Ky dokument është hartuar në përputhje me metodologjinë e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme.

IV/2 PËRMBUSHJA E QËLLIMEVE realizohet nëpërmjet:

- Ngritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të institucionit të Prefektit të Qarkut, lidhur me çështjet e menaxhimit të riskut.
- Përkufizimit të fushave të riskut dhe të detyrave specifike në veprimtarinë e administratës.
- Monitorimit të vazhdueshëm të fushave të riskut.
- Marrjes së masave për eliminimin apo pakësimin e riskut, në nivelin e pranueshëm me anë të kontrolleve.

- Informimit rast pas rasti të punonjësve të institucionit, në lidhje me risqet që kërcënojnë detyrat e tyre dhe marrjen e masave parandaluese.

IV/3 ECURIA E PROCESIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT:

- Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut janë të lidhura ngushtë me realizimin e qëllimeve të Institucionit.
- Menaxhimi i riskut është një prej elementëve të ciklit të planifikimit dhe marrjes së vendimeve.
- Përdorimi i një metode të unifikuar në identifikimin dhe analizën e riskut.
- Përditësimi i menaxhimit të riskut në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, që nxjerr Ministria e Financës, Ministria e Brendshme, apo ministritë e linjës, sipas fushave të përgjegjësisë.
- Funksionimi i procesit të vlerësimit dhe të kundërveprimit ndaj pasojave të riskut, që përfshijnë të gjithë institucionin.
- Kufizimi i riskut nëpërmjet marrjes së masave të përshtatshme korrigjuese dhe riparuese;
- Analiza e riskut është një proces i vazhdueshëm.

IV/4 DETYRIMET PËR REALIZIMIN E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT:

- Detyrimi i drejtuesve të çdo niveli, është monitorimi dhe verifikimi periodik i risqeve, që kërcënojnë realizimin e qëllimeve kryesore strategjike.
- Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut, duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm, për identifikimin dhe vlerësimin e riskut.
- Punonjësit të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
- Çdo veprim i punonjësit, i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun, duhet të mbështetet nga drejtuesit.
- Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo punonjësi.
- Për garantimin e realizimit të politikës së menaxhimit të riskut, vendosen prioritetet.

IV/5 PROCEDURA KUADËR PËR MENAXHIMIN E RISKUT

Mënyra e përshkruar më poshtë, është mënyra e veprimit në procesin e menaxhimit të riskut në institucion, bazuar në 3 (tre) dokumente kryesore:

- a. Hartimi i Planit Vjetor të Punës;
- b. Hartimi dhe përmirësimi i Rregullores së Brendshme;
- c. Hartimi dhe përditësimi i Regjistrit të Riskut, ku të përcaktohen saktë:
 - ndikimi dhe mundësia që një risk i caktuar të ndodhë;
 - përgjigja ndaj riskut – masa parandaluese, duke përfshirë ato që tashmë janë zbatuar dhe ato që janë të domosdoshme në të ardhmen (të planifikuara);
 - caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për punonjës të caktuar të Institucionit;
 - përgatitja e matricës së regjistrit të riskut.

V- METODOLOGJIA E PËRDORUR NË REALIZIMIN E PIKAVE MË SIPËR

V/1. Hartimi i Planit Vjetor të Punës

- a. Përgatitja e draftit përfundimtar të planit të punës, nga të gjithë sektorët përkatës të institucionit, për vitin pasardhës, në fillim të muajit dhjetor.
- b. Plani vjetor i punës pas rishikimeve të bëra nga drejtuesit, i dërgohet titullarit për miratim deri në përfundim muajit dhjetor të vitit.
- c. Plani vjetor duhet të marrë parasysh detyrat kryesore strategjike, mbështetur në dispozitat ligjore, rekomandimet dhe porositë e dala pas kontrollit etj., si dhe duhet të përfshijë të gjithë sektorët e institucionit.

V/2. Hartimi dhe përmirësimi i Rregullores së Brendshme

- a. Ky dokument pasqyron ecurinë e punës në administratë dhe është në përputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai shërben dhe ndihmon punonjësit për realizimin e detyrave me përgjegjshmëri, përgjegjësi, përkushtim dhe me ndershmëri profesionale.
- b. Dokumenti synon që punonjësit të orientohen drejt komunikimit (verbal ose shkresor) sa më eficient dhe informacioni i përcjellë të jetë me integritet dhe besueshmëri.
- c. Dokumenti duhet të jetë i fokusuar gjithashtu në:
 - Punën e përbashkët në grup, e bazuar në sinqeritet dhe në besim reciprok.
 - Dhënien e mundësisë së zhvillimit të tjerëve dhe respektimi i diversiteteve.
 - Inkurajimin e marrjes përsipër të sfidave, përballimit të tyre, si dhe përgjegjësi.
 -

V/3. Hartimi dhe përditësimi i Regjistrit të Riskut:

Identifikimi i zonave të riskut në kontekstin e fushës së veprimit të institucionit konsiston në përcaktimin e risqeve, mbështetur në ndarjen e tyre (për efekt ndihme):

- risqe të brendshme dhe risqe të jashtme;
- risqe financiare dhe risqe të kuadrit ligjor;
- risqe të personelit dhe risqe të tjera.

V/3.1. Përkufizimi dhe përshkrimi i riskut

Ky moment (kyç) përfshin procesin e identifikimit të risqeve të njohura gjerësisht, por edhe të risqeve të reja. Analiza ka për qëllim përshkrimin e riskut sa më mirë, me qëllim që të mundësohet vlerësimi i tij, si dhe përzgjedhja e veprimeve të duhura. Risqet mund të klasifikohen sipas objekteve (ngjarjeve, deklaratave, etj.), por edhe të subjekteve (grupet e personave, etj.). Mund të dallojmë disa faktorë të riskut, që kanë ndikim në rezultatin e analizës, p.sh.:

- Numri i punonjësve të institucionit dhe kualifikimet e tyre;
- Rekrutimi i punonjësve në institucion sipas përcaktimeve ligjore;
- Çështje të etikës dhe sjelljes së punonjësve;
- Numri, lloji dhe madhësia e detyrave të kryera, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;
- Ndryshimet e sistemeve informatike;
- Kushtet e punës në institucion.

Në mënyrë që identifikimi i riskut të jetë objektiv, i thelluar dhe afatgjatë, duhet të karakterizohet nga marrja e masave sistematike dhe të vazhdueshme, duke respektuar parimet e mëposhtme:

- identifikimi i riskut duhet të kryhet nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS);
- duhet të zhvillohet me plan dhe sistematikisht;
- prioritet duhet të konsiderohen kriteret bazë (p.sh. arritja e qëllimeve më të rëndësishme);
- identifikimi i riskut duhet të kryhet në lidhje të ngushtë me zonat e riskut.

V/3.2. Faktorët që favorizojnë lindjen e një risku:

- **dështimet në arritjen e qëllimeve në të kaluarën:** mosrealizimi i detyrës, tejkalimi i shpenzimeve të planifikuara, mosrealizimi i planit të të ardhurave;
- **parregullsi në të shkuarën:** shpenzime të parregullta, cënimi i procedurave, shkelja e rregullores së brendshme, apo rekomandimeve të Auditit të Brendshëm në MB, KLSH, etj.,
- **faktorët e riskut të lindur (të brendshëm):** karakteri i veprimtarive, numri i punonjësve, numri i transaksioneve, etj.

V/3.3. Analiza e ndikimit të riskut

Përcaktimi i ndikimit të një risku duhet të mbështetet sipas shkallës së mëposhtme:

I lartë: zgjidhja e problemit do të kërkojë shumë kohë/burime. Shmangja e pasojave do të jetë shumë e vështirë, ndoshta e pamundur. Ai do të ketë ndikim thelbësor mbi njësinë.

Mesatar: zgjidhja e problemit do të kërkojë një kohë/burime mesatare. Shmangja e pasojave do të kërkojë kohë.

I ulët: zgjidhja e problemit do të kërkojë kohë, por problemi nuk do të shkaktojë dëme të përhershme.

V/3.4. Përcaktimi i mundësisë që risku të ndodhë

Duke analizuar mundësinë që një risk i caktuar të ndodhë, duhet të merret në konsideratë se ky proces ka karakter vlerësimi subjektiv, pasi vlerësimi i riskut do të realizohet nga punonjësit Njësisë.

Pranohet se mundësia është:

E lartë: atëherë, kur ka më shumë se 60% të gjasave se risku do të ndodhë, vetëm nëse ky nuk do të zvogëlohet (ose risku do të kristalizohet në formë sistematike, ose rutinë).

Mesatare: kur gjasat janë më të larta se 10%, por më të ulëta se 60%, se risku do të ndodhë, vetëm nëse nuk zvogëlohet (ose risku të kristalizohet ose për shkaqe të jashtëzakonshme, ose rastësisht).

E ulët: kur gjasat janë më të ulëta se 10%, se risku do të ndodhë, vetëm nëse ai nuk zvogëlohet (ose risku do të kristalizohet rrallë, shfaqet e tij do të jenë të izoluar). Grupimi i risqeve sipas ndikimit dhe mundësisë së tyre, duhet t'i japë mundësinë Titullarit të Njësisë, që të përcaktojë drejtimit parësore në marrjen e masave riparuese, si dhe të nxjerrë në dukje kërcënimet reale në realizimin e detyrave të institucionit.

V/3.5. Reagimi ndaj riskut

Gjatë hartimit të regjistrit të riskut duhen përshkruar si masat e marra ashtu edhe ato të planifikuara, me karakter riparues, duke u mbështetur në rregulloren e brendshme të Prefektit të Qarkut Durrës urdhra të brendshëm, emaile, por edhe tek masat e realizuara faktikisht.

Nëse nga analizat e kryera rezulton se masat e marra deri më tani, janë të pamjaftueshme për minimizimin e një risku të caktuar, atëherë duhet të shqyrtohen dhe të pranohen procedura dhe zgjidhje të reja, të cilat e shtyjnë riskun në një nivel më të ulët mundësie.


Gjithashtu duhet mbajtur parasysh se reagimi ndaj riskut mund të marrë forma të ndryshme, të tilla si:

- **transferimi** – kalimi i riskut tek një subjekt tjetër;
- **tolerimi** – mundësitë e kufizuara për veprim, p.sh. veprimet e kufizuara deri në minimumin e kërkuar nga fusha e kompetencave, apo nga akti ligjor, që ngarkon përbushjen e qëllimeve të caktuara; kosto të larta dhe pasojat e mundshme të kristalizimit të një risku të caktuar;
- **veprimi** – hapat e marra me qëllim dobësimin e riskut deri në nivelin e pranueshëm nga institucioni, përfshirë këtu të gjitha veprimet e kryera sipas nivelit të përgjegjësisë.

V/3.6. Caktimi i detyrave konkrete ndaj një lloji të caktuar risku për punonjësit.

Caktimi i detyrave konkrete bëhet sipas një qëllimi dhe logjike të caktuar, në lidhje me planin vjetor të punës, rregulloret dhe udhëzimet e brendshme, që rregullojnë fushën e veprimit të strukturave të ndryshme në administratë. Pas hartimit apo përmirësimit të dokumenteve strategjik (Planin Vjetor i Punës, Rregulloret, etj.) dhe pasi është kryer një përmbledhje sistematike e konstatimeve, përfundimeve dhe synimeve të deritanishme, në formë grafike dhe më pas tabelare, do të paraqiten risqet më kryesore që mund të ndodhin në të ardhmen në institucion, më konkretisht:

VI- ANALIZA E RISKUT – GRAFIKË



Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

Veprimtaria e veprimtarisë së institucionit	Fusha e riskut	Përshkrimi i riskut	Ndikimi i riskut (para kontrollave)	Mundësia e Riskut (para kontrollave)	Masat e marra	Masat e planifikuara	Perspektiva e përgjigjesve të realizuar
	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)
Veprimtaria e miratimit të buxhetit dhe shpërndarjes së të ardhurave në përputhje me detyrat e përcaktuara.	Buxhet më të përafërt me kërkesat institucionale	Risku i jashtëm: Fonde të pamjaftueshme për përballimin e shpenzimeve të kërkuara.	Ndikimi i mesatar	Mundësia e ulët	Shkresa të vazhdueshme për çelje fondi drejtuar Ministrisë së Brendshme	Studim i hollësishëm i nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde për vitin 2025.	Sektorët dhe Shteti Mbështetës
Veprimtaria e përdorimit të burimeve të shtetit, si dhe shpërndarjes së arkivës së protokollin.	Kompletimi i dosjeve të personelit, si dhe respektimi i formatit zyrtar për shkresat.	Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi në fushën e hartimit të shkresave zyrtare, shpërndarja e tyre me libër dorëzimi.			Sistemi i kamerave dhe vendosja e rojeve të sigurisë, mjetet kundra zjarrit. Zbatimi korrekt i legjislacionit për arkivat.	Plotësimi i dosjeve të personelit me ndryshimet sipas rasteve.	
Veprimtaria e kontrollit të legjislacionit në fuqi.	Përpunimi i të dhënave të marra nga struktura përkatëse.	Risku i Brendshëm: Trajtimi me vonesë i akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me fushën e veprimtarisë.	Ndikimi i lartë	Mundësia e ulët	Azhurnimi në kohë reale me botimet zyrtare në fushën e legjislacionit.	Pjesëmarrje në trajnime dhe shkëmbim eksperiencash	Sektorët
Veprimtaria e kontrollit të ligjshmërisë së akteve normative të marra nga organet e shtetit.	Shprehja mbi ligjshmërinë apo jo të akteve normative, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe duke respektuar afatet.	Risku i brendshëm Mos njohja e legjislacionit në fuqi si dhe mos konfirmimi i akteve normative nga të gjithë	I lartë	I ulët	Azhurnimi i sektorëve me legjislacionin në fuqi dhe shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve normative nga sektori juridik dhe sektorët përgjegjës sipas	Pjesëmarrja e të gjithë sektorëve në tryeza të rumbullakëta dhe trajnime të ndryshme.	Sekretariati i Përgjithshëm dhe Sektorët

		sektorët përgjigjës.			fushës së veprimtarisë.		
Nxjerrja e akteve administrative në përputhje me kompetencat e Prefektit.	Ligjshmëria e këtyre akteve dhe nxjerrja brenda kompetencave ligjore.	Risku i brendshëm Nxjerrja e akteve të jashtëligjshme dhe në tejkalim të kompetencave.	I lartë	E ulët	Sektori juridik të shprehet për ligjshmërinë e aktit administrativ të prefektit.	Çdo akt administrativ i Prefektit t'i kalojë Sektorit Juridik për të shqyrtuar ligjshmërinë e tij. Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë sektorët të mos kalojnë asnjë akt administrativ të Prefektit pa marrë konfirmimin për ligjshmëri nga Sektori Juridik.	Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë sektorët të mos kalojnë asnjë akt administrativ të Prefektit pa marrë konfirmimin për ligjshmëri nga Sektori Juridik.
Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve	Konstatim i akteve me karakter normativ të organeve të NJVQV, të pa depozituara në institucionin e Prefektit për verifikim ligjshmërie.	Risku i brendshëm Mos depozitimi në Gjykatë i akteve me karakter normativ të padepozituara tek Prefekti për shprehje ligjshmërie dhe të cilat konstatohen nga Prefekti jo në pajtueshmëri me ligjin.	I lartë	I ulët	Kontroll periodik jo më pak se çdo tre muaj. Mbajtja e një regjistri të akteve të depozituara për verifikim ligjshmërie.	Dërgimi në Gjykatë i akteve normative të padepozituara dhe të konstatuara jo në pajtueshmëri me ligjin.	
Bashkërendimi i punës së KQZ dhe struktura të tjera zgjedhore në përputhje me ligjin Zgjedhor.	Respektimi i afateve dhe bashkërendimi i punës me NJVQV dhe KQZ.	Risku i brendshëm Mos respektimi i afateve dhe mos njohja e Kodit Zgjedhor në lidhje me kompetencat e Prefektit.	I lartë	I ulët	Evidentimi i detyrave të Prefektit në lidhje me zgjedhjet.	Bashkërendimi i punës me sektorët e tjerë.	Sektorët e tjerë.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

Shikimi i proceseve gjyqësore ku Prefekti është palë.	Njohja e ligjit dhe respektimi i afateve.	Risk i brendshëm. Humbja e proceseve gjyqësore për shkak të mos njohjes së ligjit, procedurës ligjore dhe mos respektimit të afateve.	I lartë	I mesëm	Caktimi i personave përgjegjës për ndjekjen e proceseve gjyqësore.	Bashkërendimi i punës edhe me sektorët e tjerë.	Sektor
Kontrollimi i procedurës së miratimit dhe miratimit të projektbuxhetit, shikimi i zbatimit të tij dhe përputhja me aktivitetet e përcaktuara.	Vonesat në shqyrtimin e akteve normative të buxhetit.	Risk i brendshëm. Mospërfundimi i kontrollit të akteve buxhetore të NJVQV brenda afateve ligjore të nevojshme për funksionimin normal të NJVQV.	E lartë	Mesatar	Raportime periodike	Trajnim i stafit për mbledhje të dhënash.	SMK
Shikimi i akteve dhe akteve të transparencës.	Mungesa e transparencës.	Mospublikimi i akteve.	Mesatar	I ulët	Publikimi në faqen zyrtare të NJVQV.	Automatizim i publikimeve.	SMK
Bashkërendimi i punës ndërmjet institucioneve qendrore dhe organeve të NJVQV.	Mungesa e bashkëpunimit për programet e zhvillimit në nivel qarku.	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve.	I mesëm	I ulët	Mbledhje koordinuese.	Tryeza të rrumbullakta.	Sek. I SMK
Mbikqyrja e sezonit turistik, drejtimi i Task Forcës së turizmit dhe planimet e sigurisë në sezon.	Bashkërendimi i punës me strukturat përkatëse për mbarrëvajtjen e sezonit turistik.	Mos trajtimi i problemit nga institucioni kompetent. Moszbatimi i dispozitave ligjore në fuqi. Moszbatimi i detyrave të përcaktuara nga Task Forcave të veçanta	I mesëm	I ulët.	Koordinimi i punës së institucioneve anëtare të Task Forcës vendore për sezonin turistik.	Mbikqyrja e planit të veprimit.	SMK

mbushja e detyrimeve re në lidhje me nin.	Siguria në shkolla.	Mos grumbullimi i të dhënave me tregues statistikor, vjetor dhe afat-mesëm duke mos bashkërenduar me organizmat e specializuara vendor. Mos azhurnimi në kohën e duhur me ndryshimet aktet ligjore dhe nënligjore. Pajisjet e zyrës/mosfunk sionim për arsye të përdorimit për një kohë të gjatë.	I mesëm	I ulët	Organizimi i mbledhjeve të Task Forcës për sigurinë në shkolla.	Monitorimi i problematikave që lindin gjatë vitit akademik.	SMK
imi dhe zbatimi i etit	Financiar	Risku i brendshëm Gabime në hartmin e buxhetit	I mesëm	I ulët	Procedura të miratuara për përgatitjen e buxheti, miratimi nga Ministria Financave.	Trajnime shtesë për stafin financiar. Kryerja ne kohë e pagesave dhe kryerja e të gjitha procedurave për kontabilizimin e tyre.	Sekto Prefek
ministrimi i aseteve automjeteve.	Operacional	Risku i brendshëm Keqpërdorimi ose dëmtimi i aseteve për shkak të mungesës së kontrollit.	I mesëm	I ulët	Evidenca e aseteve, mirëmbajtje periodike dhe kontrata shërbimi	Inventarizim periodik, planifikimi i mirëmbajtjes	Sekto admin
jtja e kontabilitetit	Financiar	Risku i brendshëm Pasaktësi në regjistrimin e transaksioneve financiare	I mesëm	I ulët	Përdorim i sistemeve kontabël dhe procedura kontrolli	Forcim i kontrolleve të brendshme	Sekto

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

ortimi shpenzimeve etore	Financiar	Risku i brendshëm Raportim i vonuar ose i pasaktë i shpenzimeve në Ministrinë e Financave.	I mesëm	I ulët	Respektimi afateve	Monitorimi në kohë	Sektor
ësimi i vendeve nte nga DAP,	Administrativ	Risku i jashtëm Ndikimi në institucion nga mos plotësimi i vendeve vakante nga DAP, si organ përgjegjës.(i jashtëm)	I lartë	I mesatar	Korespondencë e vazhdueshme me DAP për plotësimin e vendeve vakante	Vazhdimësia e këtij procesi	Sektor
istrimi i praktikave shpërndarja e spondencës	Administrativ	Risku i brendshëm Vonesa në regjistrim, humbje apo mos shpërndarje e korespondencës	I mesëm	I ulët	Protokoll, hyrje-dalje	Verifikime periodike	Zyra Sektor dhe sh mbësht
itorimi i NJVQV pastrimin, hapësirat lbra, mjedisin	Mungesë raportimi të rregullt nga bashkitë.	Bashkitë nuk dërgojnë të dhëna periodike mbi gjëndjen e patrimet, menaxhimit të mbetjeve, gjelbërimit.	I mesëm	I mesëm	Kërkohen raporte periodike me shkrim	Vendosja e afateve të detyrueshme dhe raportimi javor/mujor.	Sektor Zhvill
ifikimi i Zhvillit të itorit për Bashkinë ak	Mos hartimi dhe mos shqyrtimi i planit vendor të zhvillimit të territorit për Bashkinë Shijak	Plani i përgjithshëm vendor nuk miratohet në kohë dhe pengon zhvillimin	I mesëm	I mesëm	Monitorim nga prefekti.	Mbledhje koordinuese.	Prefekti Sektor Zhvill
at e mbrojtura disore	Rrezik degradimi mjedisor	Mozbatimi i programeve nga administrata përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe	I lartë	I mesëm	Kërkohen raportime nga administrata e zonave të mbrojtura	Hartimi i planeve për menaxhimin e zonave dhe organizimi i mbledhjeve periodike të Komitetit të Zonave të Mbrojtura mjedisore.	Prefekti Sektor Zhvill Sekre Përgj

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

		NJVQV dëmtojnë zonat e mbrojtura.					
Monitorimi i pastrimit të qesëve dhe hapësirave publike	Mungesë ndërhyrje në kohë nga NJVQV	Mos zbatimi i detyrimeve nga bashkitë për pastrim parqesh dhe lulishte.	I mesëm	I mesëm	Njoftohen bashkitë për vonesa	Kërkesë për informacion.	Sektor Zhvillim
Monitorim dhe informim periodic Prefektit të Qarkut	Mospërditësim i të dhënave	Mungesë informacioni për ecurinë e punës së prefektit.	I mesëm	I mesëm	Dhënia e raportimit në afatet e caktuara.	Përgatitja e raportit mujor.	Sektor Zhvillim
Monitorimi dhe informimi nga NJVQV për zhvillim të rueshëm.	Zbatimi i detyrave për një zhvillim të qëndrueshëm vendor	Mos dhënia e informacionit nga NJVQV.	I mesëm	I mesëm	Informimi mbi ecurinë.	Kërkesë për informacion	Sektor Zhvillim
Ndjekja, monitorimi dhe vlerësimi i punës në Task Forcën për ndalimin e qesës për prodhimin e plastikës, hedhjes në tërësi apo futjes në qarqin e Republikës së Shqipërisë të qeseve publike mbajtëse, si dhe qesëve plastike mbajtëse të oxo- biodegradueshme dhe biodegradueshme.	Zbatimi i detyrimeve të Task Forcës për marrjen e masave dhe veprimeve në këtë drejtim	Mungesë e raportimit të rregullt nga antarët pjesë e Task Forcës në nivel Qarku	I mesëm	I mesëm	Informim periodik	Kërkesë për informacion	Prefekti Sektor Zhvillim
Ndjekja e procedurës së verifikimit dhe konfirmimit të Gen Planit në procedurat e privatizimit që kryen nga Ministria e Financës dhe Bujqësisë, (Dr.së Planit të Pronës publike) në zbatim të ligjeve ligjore.	Zbatimi i detyrimeve ligjore që i linden Prefektit të Qarkut dhe personit të autorizuar prej tij në këtë drejtim	Mos zbatimi i detyrimeve ligjore në kryerjen e procedurës së verifikimit në terren, matjeve dhe konfirmimit ose jo të Gen Planit të objektit në privatizim konform ligjit	I lartë	I lartë	Zbatimi i të gjitha procedurave shkresore, verifikimi në terren nga personi i autorizuar për këtë proces si dhe miratimi ose jo i Gen Planit të objektit në proces privatizimi.	Informim dhe ndjekja e procedurave në zbatim të kriterëve të përcaktuara ligjore.	Prefekti Personi autorizuar Prefekti Sektor Zhvillim

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Ushtrimin e Funksioneve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

imi i dokumentave egjike në fushën e ojtjes civile (nivel u dhe bashkie); i i Emergjencave le; umenti i vlerësimit kut nga Ftakeqësitë; egjia për gëlimin e riskut nga eqësitë 2023-2030 Plani i Veprimit.	Cënim i funksionimit të Sistemit të Mbrojtjes Civile	Moszbatimi VKM-së Nr. 94, datë 22.02.2023 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit”; VKM-së Nr. 168, datë 24.03.2023 “Për Miratimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qëndror”; VKM-së Nr. 807, datë 28.12.2023 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”.	I lartë	I lartë	Zbatimi korrekt i legjislacionit në fushën e mbrojtjes civile. Ndjekja e praktikës shkresore me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore dhe qëndrore mbi problematikat e proçesit.	Përpjekjet intensive të Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave me GIZ mbi mundësinë e hartimit të dokumentave.	Sektor Planif Përba Emer Civile
li i kushtëzuar për ojtjen civile	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë nëpërmjet marrjes së masave paraprake	Moszbatim të VKM-së Nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, e ndryshuar.	I lartë	I lartë	Rekomandimi për Bashkitë për përdorimin sipas prioritizimit të fondit në kuadër të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.		Sektor Planif Përba Emer Civile

nia e ndihmës ërore financiare për limin e dëmeve të ktuara nga fatkeqësi rore ose fatkeqësi të të shkaktuara nga imprimtari njerëzore.	Përballimi dhe rehabilitimi pas ndodhjes së fatkeqësisë	VKM-ja Nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore”.	I Lartë	I lartë	Respektim rigoroz i kriterëve dhe procedurave të përcaktuara.		Sektor Planif Përba Emerg Civile
---	--	--	---------	---------	---	--	--

31	Pastrim i kanaleve të para, të dyta dhe të ujrave të larta dhe mirfunksionimi i hidrovorëve	Risk i lartë për përmbytje	Mirëmenaxhimi i kanaleve në kohën e duhur do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i rreshjeve.	I lartë	I lartë	Hartimi dhe miratimi: Plani i Masave “Për parandalimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave të mundshme të krijuara gjatë sezonit vjeshtë - dimër, 2025 - 2026”; Plani i Veprimit “Për rradhën e punës dhe procedurat që do të ndiqen në rastet e problematikave nga rreshjet gjatë sezonit	Përcjellja dokumen struktura dhe organ mbledhje të Mbrojt Qark.
----	---	-------------------------------	--	---------	---------	--	---

						<i>vjeshtë - dimër, 2025 - 2026”.</i>	
32	Kapacitetet logjistike në mjete dhe burime njerëzore të M.Z.Sh-ve	Ndërhyrja jo në kohë në situatat e zjarreve, vështirësia e operacioneve të ndërhyrjes, izolimi dhe fikja e zjarreve	Forcimi i kapaciteteve.	I lartë	I lartë	Kërkesa për bashkitë për vëmendje të shtuar në kuadër të forcimit të kapaciteteve.	

VIII- KRIJIMI I MATRICËS SË RISKUT

Hartimi i një diagrami që grupon risqe të ndryshme sipas ndikimit të tyre, në raport me mundësinë që ato të ndodhin (pra të matricës së riskut), është metoda më e thjeshtë që tregon në formë tabelare, ato fusha të veprimtarisë për të cilat institucioni, duhet të tregojë vëmendje të veçantë në realizimin e objektivave kryesorë të identifikuara në këtë dokument.

Shënim: Matrica në vijim (ilustrim) ka evidentuar risqet përpara reagimit dhe marrjes së masave nga strukturat përkatëse. Matrica e risqeve përftohet sipas modelit të mëposhtëm:

Mundësia	I lartë			27,28,29,30,31,32
	Mesatar		20,21,23,24,25,26,	8,9,18,22,
	I ulët		1,2,10,11,12,13,14,15,16,17,19,	3,4,5,6,7,
		I ulët	Mesatar	I lartë
	Ndikimi			

Identifikimi i riskut sipas 9 zonave:

- zona me prioritet absolut, që kërkon kontrollin e vazhduar të Institucionit;
- zonë me rëndësi të madhe, që kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme;
- zonë me rëndësi të madhe, por ka pak të ngjarë të ndodhë – kontrolli me cikle;
- zonë me rëndësi të madhe që kërkon kontroll të vazhdueshëm nga ana e nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit;
- zonë me rëndësi, që kërkon mbikëqyrje ciklike të nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit;

Identifikimi i risqeve kryesore:


- zonë potencialisht e rëndësishme, por me pak mundësi që të ndodhë;
- zonë kërcënimesh jo shumë të rëndësishme, që kërkon monitorimin në nivel punonjësish;
- zonë kërcënimesh pak të rëndësishme që kërkon vetëm mbikëqyrje sporadike dhe raportim në periudha kohore të distancuara nga njëra-tjetra;

Identifikimi i risqeve kryesore:

- zonë kërcënimesh thuhet të parëndësishme.

Pas krijimit të matricës së riskut, hapat që do të ndiqen në vlerësimin e tij, do të jenë sipas grafikës më poshte:

IX- VLERËSIMI I RISKUT - GRAFIKË



X- MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Kjo është një faza në të cilën titullari i institucionit, bën përzgjedhjen dhe vlerësimin e mjeteve si dhe metodave të monitorimit mbi procesin e menaxhimit të riskut. Kjo procedurë duhet të kalojë sipas një sistemi raportimi, për të garantuar një kontrolli efektiv të risqeve.

IX/1. Për sistemin e raportimit duhet që:

IX/1.1. Grupi për Çështjet e Menaxhimit të Riskut, i cili korrespondon me Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS), njëherë në 6 (gjashtë) muaj, përgatit një informacion me shkrim lidhur me punën e grupit, i cili më pas i përcillet titullarit të institucionit.

IX/1.2. Në situata kur ndodhin ngjarje të caktuara, të cilat kanë ndikim tek menaxhimi i riskut, çdo punonjës ka detyrimin për të informuar lidhur me këtë fakt Koordinatorin e Menaxhimit të Riskut, ose eprorin e tij të drejtpërdrejtë.

IX/1.3. Në rastin e informimit të eprorit të drejtpërdrejtë, ky i fundit ka detyrimin të informojë lidhur për sa më sipër Koordinatorin e Riskut.

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

EMILJAN JANI